

STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMIT 720 (I RISHIKUAR)

PËRGJEGJËSITË E AUDITUESIT NË LIDHJE ME INFORMACIONET E TJERA

(Ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2016 ose pas kësaj date)

PËRMBAJTJA

	Paragrafi (ët)
Hyrje	
Objekti i këtij SNA-je	1-9
Hyrja në fuqi	10
Objektivat	11
Përkufizimet	12
Kërkesat	
Sigurimi i informacioneve të tjera	13
Leximi dhe vlerësimi i informacioneve të tjera	14-15
Reagimi kur duket se ekziston një inkoherencë (mospërputhje) materiale ose kur informacionet e tjera duket se kanë anomali materiale	16
Reagimi kur audituesi arrin në përfundimin se në informacionet e tjera ekziston një anomali materiale	17-19
Reagimi kur në pasqyrat financiare ekziston një anomali materiale ose kur duhet të aktualizohet njohja e audituesit për entitetin dhe mjedisin e tij	20
Raportimi	21-24
Dokumentimi	25
Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese	
Përkufizimet	A1- A10
Sigurimi (mbledhja) e/i informacioneve të tjera	A11-A22
Leximi dhe vlerësimi i informacioneve të tjera	A23-A38
Reagimi kur duket se ekziston një inkoherencë (mospërputhje) materiale ose kur informacionet e tjera duket se kanë anomali materiale	A39-A43
Reagimi kur audituesi arrin në përfundimin se në informacionet e tjera ekziston një anomali materiale	A44-A50
Reagimi kur ekziston një anomali materiale në pasqyrat financiare ose kur duhet të aktualizohet njohja e audituesit për entitetin dhe mjedisin e tij	A51
Raportimi	A52-A59
Shtojca 1 : Shembuj të shumave ose zërave të tjera që mund të jenë përfshirë në informacionet e tjera.	
Shtojca 2: Ilustrime të raporteve të audituesit lidhur me informacionet e tjera	

Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 720 (i rishikuar), *Përgjegjësitë e Audituesit Lidhur me Informacionet e Tjera*, duhet të lexohet i lidhur ngushtë me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 200, *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*.

Hyrje

Objekti i këtij SNA-je

1. Ky Standard Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) trajton përgjegjësitë e audituesit në lidhje me informacionet e tjera, financiare ose jo financiare (që ndryshojnë nga pasqyrat financiare të audituara dhe raporti i audituesit mbi këto pasqyra), që përfshihen në raportin vjetor të një entiteti. Raporti vjetor i një entiteti mund të jete një dokument i vetëm, ose një kombinim i dokumenteve që i shërbejnë të njëjtit qëllim.
2. Ky SNA është shkruar në kontekstin e një auditimi të pasqyrave financiare nga një auditues i pavarur. Për rrjedhojë, objektivat në këtë SNA duhet të kuptohen në kontekstin e objektivave të përgjithshme të audituesit, të shpallura në paragrafin 11 të SNA 200¹. Kërkesat në këtë SNA synojnë t'i japin audituesit mundësinë që ai të arrijë objektivat e specifikuar në SNA-të dhe, përmes tyre, objektivat e përgjithshme të audituesit. Opinioni i audituesit mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera, dhe as ky SNA nuk kërkon që audituesi të sigurojë evidencë auditimi përtej asaj që kërkohet për të formuar një opinion mbi pasqyrat financiare.
3. Ky SNA kërkon që audituesi të lexojë dhe të vlerësojë informacionet e tjera, për arsye se informacionet e tjera që kanë inkoherenca (mospërputhje) materiale me pasqyrat financiare ose me njohjen e siguruar nga audituesi gjatë auditimit, mund të tregojnë se ka një anomali materiale në pasqyrat financiare ose që ekziston një anomali materiale në informacionet e tjera, ku çdonjëra prej tyre mund të dëmtojë besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe të raportit të audituesit mbi këto pasqyra. Këto anomali materiale mund të influencojnë në mënyrë të papërshtatshme vendimet e përdoruesve për të cilët është përgatitur raporti i audituesit.
4. Gjithashtu, ky SNA mund të ndihmojë audituesin për të qenë në pajtim me kërkesat përkatëse etike², të cilat kërkojnë që audituesi të shmangë lidhjen e tij, me dashje, me informacionet që audituesi beson se përmbajnë një deklaramë të fals ose çorientues, me deklaratat ose informacionet e marra nxitimthi, apo me mungesat ose fshehjet e informacioneve që duhet të përfshihen, kur këto mungesa apo fshehje do të ishin çorientuese.

¹ SNA 200, *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*

² Kodi i Etikës për Profesionistët Kontabël, i Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (IESBA Code), paragrafi 110.2.

5. Informacionet e tjera mund të përshijnë shuma ose elemente të tjera, që parashikohet të jenë të njëjta, në lidhje me përmbledhjen ose dhënien e më shumë detajeve rreth shumave dhe elementëve të tjerë në pasqyrat financiare, dhe shuma ose elementë të tjerë, me të cilët audituesi është njohur gjatë auditimit. Informacionet e tjera mund të përshijnë edhe çështje të tjera.
6. Përgjegjësitë e audituesit në lidhje me informacionet e tjera (që ndryshojnë nga përgjegjësitë e zbatueshme të raportimit) zbatohen pavarësisht faktit nëse informacionet e tjera janë siguruar nga audituesi para, apo pas datës së raportit të audituesit.
7. Ky SNA nuk zbatohet për:
 - (a) Shpalljen paraprake të informacioneve financiare, ose
 - (b) Dokumentet me të cilat ofrohen letrat me vlerë, përfshirë prospektet.
8. Përgjegjësitë e audituesit sipas këtij SNA-je nuk përbëjnë një angazhim të sigurisë mbi informacionet e tjera dhe as imponojnë një detyrim mbi audituesin që ai të japë siguri rreth këtyre informacioneve.
9. Ligji ose rregullat mund t'i imponojnë audituesit detyrime shtesë në lidhje me informacionet e tjera që janë përtej objektit të këtij SNA-je.

Hyrja në fuqi

10. Ky SNA hyn në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare të periudhave që përfundojnë me datën 15 Dhjetor 2016 ose pas kësaj date.

Objektivat

11. Objektivat e audituesit, pasi ka lexuar informacionet e tjera, janë:
 - (a) Të vlerësojë nëse ka një inkoherencë materiale midis informacioneve të tjera dhe pasqyrave financiare;
 - (b) Të vlerësojë nëse ka një inkoherencë materiale midis informacioneve të tjera dhe njohurive që audituesi ka siguruar gjatë auditimit;
 - (c) Të reagojë në mënyrën e duhur, kur audituesi identifikon se duket se ekzistojnë këto inkoherenca materiale, ose kur audituesi përndryshe, bëhet i vetëdijshëm se informacionet e tjera duket se kanë anomali materiale.
 - (d) Të raportojë në përputhje me këtë SNA.

Përkufizimet

12. Për qëllime të SNA-ve, termat në vijim kanë kuptimet e mëposhtme:

- (a) Raporti vjetor - Një dokument i vetëm, ose kombinimi i dokumenteve, të përgatitur, si rregull çdo vit, nga drejtimi ose nga personat e ngarkuar me qeverisjen, bazuar në kërkesat ligjore, rregullatore ose të praktikës, qëllimi i të cilit është t'ju japë pronarëve (ose aksionarëve të ngjashëm) informacione mbi veprimtaritë e entitetit, rezultatin financiar të entitetit dhe për pozicionin financiar, sikurse është paraqitur në pasqyrat financiare. Një raport vjetor përmban ose përfshin pasqyrat financiare dhe raportin e audituesit mbi këto pasqyra dhe zakonisht, përfshin informacione mbi zhvillimet e entitetit, perspektivën e tij të ardhshme, rreziqet dhe pasiguritë, një deklaratë të organit qeverisës të entitetit dhe raportet që mbulojnë çështje të qeverisjes (Ref: Para. A1-A5)
- (b) Anomalia e informacioneve të tjera - Një anomali në informacionet e tjera ekziston kur informacionet e tjera janë paraqitur në mënyrë të pasaktë ose përndryshe, çorientuese (përfshirë mungesat apo fshehjen e informacioneve që nevojiten për një kuptim të përshtatshëm të një çështje të shpjeguar në informacionet e tjera) (Ref: Para. A6-A7)
- (c) Informacionet e tjera - informacionet financiare ose jo financiare (që ndryshojnë nga pasqyrat financiare të audituara dhe raporti i audituesit mbi këto pasqyra), të përfshira në raportin vjetor të një entiteti. (Ref: Para. A8-A10)

Kërkesat**Sigurimi i Informacioneve të tjera**

13. Audituesi do të: (Ref: Para. A11-A22)

- (a) Përcaktojë, përmes diskutimeve me drejtimin, se cilat dokumente përfshihen në raportin vjetor, dhe mënyrën e planifikuar të entitetit dhe afatet e lëshimit të këtyre dokumenteve;
- (b) Bëjë marrëveshjet e duhura me drejtimin, për të siguruar në kohë, dhe nëse është e mundur, para datës së raportit të audituesit, versionin përfundimtar të dokumenteve që përfshihen në raportin vjetor, dhe
- (c) Kur disa ose të gjitha dokumentet e përcaktuar në shkronjën (a) nuk do të jenë disponibël deri pas datës së raportit të audituesit, ti kërkojë drejtimin të bëjë deklaratime me shkrim se audituesit do ti jepen dokumentet përfundimtare, sapo ato të jenë gati, dhe para se ato të publikohen nga entiteti, kështu që audituesi mund të kryejë procedurat e kërkuara nga ky SNA (Ref: Para. A22)

Leximi dhe vlerësimi i Informacioneve të tjera

14. Audituesi do të lexojë informacionet e tjera dhe do të: (Ref: Para. A23-A24)

- (a) Vlerësojë nëse ka një inkoherencë (mospërputhje) materiale midis informacioneve të tjera dhe pasqyrave financiare të audituara. Për të bërë këtë vlerësim për koherencën e tyre, audituesi do të krahasojë shumat e zgjedhura ose elementet e tjera në informacionet e tjera (që parashikohet të jenë të njëjta, në lidhje me përmbledhjen ose dhënien e më shumë detajeve rreth shumave dhe elementëve të tjera në pasqyrat financiare) me këto shuma ose elementët e tjera në pasqyrat financiare; dhe (Ref: Para. A25-A29)
- (b) Vlerësojë nëse ka një inkoherencë materiale midis informacioneve të tjera dhe njohurive që audituesi ka marrë gjatë auditimit, në kontekstin e evidencës së auditimit të siguruar dhe konkluzioneve të arritura gjatë auditimit (Ref: Para. A30-A36).

15. Kur lexon informacionet e tjera, në pajtim me paragrafin 14 audituesi do të jetë vigjilent për indikacionet që tregojnë se informacionet e tjera, të cilat nuk lidhen me pasqyrat financiare ose me njohuritë që audituesi ka siguruar gjatë auditimit, kanë anomali materiale (Ref: Para. A24, A37-A38)

Reagimi kur duket se ekziston një inkoherencë (mospërputhje) materiale ose kur informacionet e tjera duket se kanë anomali materiale

16. Nëse audituesi identifikon shenja të ekzistencës se një inkoherece materiale (ose vihet në dijeni të faktit se informacionet e tjera duke se kanë anomali materiale) ai do të diskutojë për këtë çështje me drejtimin dhe, sipas nevojës, do të kryejë procedurat për të konkluduar nëse; (Ref. Para. A39-A43).

- (a) Ekziston një anomali materiale në informacionet e tjera;
- (b) Ekziston një anomali materiale në pasqyrat financiare; ose
- (c) Duhet të aktualizohet njohja e audituesit për entitetin dhe mjedisin e tij.

Reagimi kur audituesi arrin në përfundimin se në informacionet e tjera ekziston një anomali materiale

17. Nëse audituesi arrin në përfundimin se në informacionet e tjera ka një anomali materiale, ai do të kërkojë drejtimin të korrigjuesit të informacionet e tjera. Nëse drejtimi:

- (a) Pranon të bëjë korrigjimin, audituesi do ta konsiderojë korrigjimin të kryer, ose
- (b) Refuzon të bëjë korrigjimin, audituesi do të komunikojë për çështjen me personat e ngarkuar me qeverisjen duke ju kërkuar atyre që të bëhet korrigjimi.

18. Nëse audituesi arrin në përfundimin se ka një anomali materiale në informacionet e tjera të siguruara para datës së raportit të audituesit, dhe pas komunikimit me personat e ngarkuar me qeverisjen, informacionet e tjera nuk janë korrigjuar, audituesi do të ndërmarrë veprimet e duhura, duke përfshirë: (Ref: Para. A44)
- (a) Vlerësimin e ndikimeve në raportin e audituesit dhe komunikimin me personat e ngarkuar me qeverisjen për mënyrën se si audituesi planifikon të adresojë anomalinë materiale në raportin e audituesit (shiko paragrafin 22(e)(ii)); ose (Ref: Para. A45)
 - (b) Tërheqjen nga angazhimi, kur një gjë e tillë lejohet, sipas ligjeve dhe rregullave që zbatohen. (Ref: Para. A46-A47)
19. Nëse audituesi arrin në përfundimin se ka një anomali materiale në informacionet e tjera të siguruara pas datës së raportit të audituesit, audituesi do të:
- (a) Kryejë procedurat e nevojshme për rrethanat, kur informacionet e tjera janë korrigjuar; ose (Ref: Para. A48)
 - (b) Ndërmarrë veprimet e duhura, përfshirë të drejtat dhe detyrimet e tij ligjore, kur edhe pas komunikimit me organet e ngarkuara me qeverisjen, informacionet e tjera nuk janë korrigjuar, duke kërkuar që anomalitë materiale të pakorrigjuara të sillen në vëmendjen e përdoruesve për të cilët përgatitet raporti i audituesit (Ref: Para. A49-A50)

Reagimi kur në pasqyrat financiare ekziston një anomali materiale ose kur duhet të aktualizohet njohja e audituesit për entitetin dhe mjedisin e tij

20. Nëse, si rrjedhojë e kryerjes së procedurave të paragrafëve 14-15, audituesi arrin në përfundimin se ka një anomali materiale në pasqyrat financiare, ose që duhet apo që ka nevojë të aktualizohet njohja e audituesit për entitetin dhe mjedisin e tij, audituesi do të reagojë në mënyrën e duhur në pajtim me SNA-të e tjera (Ref: Para. A51)

Raportimi

21. Raporti i audituesit do të përfshijë një seksion të veçantë të titulluar “Informacione të tjera”, ose një titull tjetër të përshtatshëm, kur në datën e raportit të audituesit:
- (a) Për një auditim të pasqyrave financiare të një entiteti të listuar, audituesi ka siguruar, apo pret të sigurojë, informacionet e tjera; ose
 - (b) Për një auditim të pasqyrave financiare të një entiteti të pa listuar, audituesi ka siguruar një pjesë ose të gjithë informacionet e tjera. (Ref: Para. A52)

22. Kur raporti i audituesit kërkohet të përfshijë një seksion për informacione të tjera në pajtim me paragrafin 21, ky seksion do të përfshijë: (Ref: Para. A 53)
- (a) Një deklaratë që drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera
 - (b) Një identifikim të:
 - (i) Informacioneve të tjera, nëse ka të tilla, që audituesi i ka siguruar para datës së raportit të audituesit; dhe
 - (ii) Për një auditim të pasqyrave financiare të një entiteti të listuar, të informacioneve të tjera, nëse ka të tilla, të parashikuara të sigurohen pas datës së raportit të audituesit;
 - (c) Një deklaratë që opinioni i audituesit nuk mbulon informacionet e tjera, dhe për rrjedhojë, audituesi nuk shpreh (ose nuk do të shprehë) një opinion auditimi ose ndonjë formë të konkluzioneve të sigurisë në lidhje me këto informacione.
 - (d) Një përshkrim të përgjegjësive të audituesit në lidhje me leximin, vlerësimin dhe raportimin mbi informacionet e tjera siç kërkohet nga ky SNA; dhe
 - (e) Kur informacionet e tjera janë siguruar para datës së raportit të audituesit, ose:
 - (i) Një deklaratë që audituesi nuk ka asgjë për të raportuar, ose
 - (ii) Nëse audituesi ka arritur në përfundimin se ka një anomali materiale të pakorrigjuar në informacionet e tjera, një deklaratë që përshkruan anomalinë materiale të pakorrigjuar, të informacioneve të tjera.
23. Kur audituesi shpreh një opinion me rezerve ose opinion kundër në pajtim me SNA 705 (i rishikuar)³, audituesi do të vlerësojë pasojat e çështjes që ka çuar në modifikim të opinionit për deklaratën e kërkuar në paragrafin 22(e) (Ref: Para. A54-A58)

Raportimi i Përshkruar nga Ligji ose Rregullat

24. Nëse, nga ligji ose rregulli i një juridiksioni të caktuar, audituesi kërkohet të bëjë referim në raportin e tij të audituesit tek informacionet e tjera, duke përdorur një tekst ose një formulim të veçantë, raporti i audituesit do të referohet Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) vetëm nëse raporti i audituesit përfshin, të paktën: (Ref: Para. A59)
- (a) Identifikimin e informacioneve të tjera të siguruar nga audituesi para datës së raportit të audituesit;

³ SNA 705 (i rishikuar), *Modifikimet e Opinioneve në Raportin e Audituesit të Pavarur*

- (b) Një përshkrim të përgjegjësive të audituesit në lidhje me informacionet e tjera; dhe
- (c) Një deklaratë të qartë, e cila adreson rezultatin e punës së audituesit për këtë qëllim.

Dokumentimi

25. Në adresimin e kërkesave të SNA 230⁴, kur ato zbatohen për këtë SNA, audituesi do të përfshijë në dokumentacionin e auditimit:
- (a) Dokumentacionin e procedurave të kryera sipas këtij SNA-je; dhe
 - (b) Versionin përfundimtar të informacioneve të tjera, mbi të cilat audituesi ka kryer punën e kërkuar sipas këtij SNA-je.

Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese

Përkufizimet

Raporti vjetor (Ref: Para. 12(a))

- A1. Për entitetet që veprojnë në një juridiksion të caktuar, përmbajtja e një raporti vjetor dhe emri, me të cilin ai duhet të referohet, mund të përcaktohen nga ligji, rregullat ose praktika; megjithatë, përmbajtja dhe emri mund të ndryshojnë si brenda për brenda juridiksionit ashtu edhe nga njeri juridiksion tek tjetri.
- A2. Një raport vjetor si rregull përgatitet mbi një bazë vjetore. Megjithatë, kur pasqyrat financiare që auditohen janë përgatitur për një periudhë më të shkurtër se një vit, gjithashtu mund të përgatitet një raport vjetor që mbulon të njëjtën periudhë që mbulojnë pasqyrat financiare.
- A3. Në disa raste, raporti vjetor i një entiteti mund të jetë një dokument i vetëm i referuar me titullin “raporti vjetor” ose me një titull tjetër. Në raste të tjera nga ligji, rregullat ose praktika mund të kërkohet që entiteti të raportojë për pronarët (ose për palë të interesuara të ngjashme) informacione mbi veprimtaritë e shfrytëzimit të entitetit, rezultatet financiare të entitetit dhe pozicionin e tij financiar, sikurse këto janë paraqitur në pasqyrat financiare (d.m.th. një raport vjetor) nëpërmjet një dokumenti të vetëm, ose nëpërmjet dy apo më shumë dokumenteve, të cilat të kombinuara i shërbejnë të njëjtit qëllim. Për shembull, në varësi të ligjit, rregullave ose praktikës që ndiqet në një juridiksion të caktuar, pjesë përbërëse të raportit vjetor do të ishin një ose disa nga dokumentet e mëposhtme:

⁴ SNA 230, *Dokumentimi i auditimit*, paragrafët 8-11

- Raporti i drejtimit, komentaret e drejtimit ose rishikimet financiare dhe të shfrytëzimit ose raporte të ngjashme nga personat e ngarkuar me qeverisjen (për shembull raporti i drejtorëve).
 - Raporti i kryetarit.
 - Raporti për qeverisjen e shoqërisë tregtare.
 - Raportet e vlerësimit të kontrollit të brendshëm dhe të rrezikut.
- A4. Një raport vjetor mund t'ju vihet në dispozicion përdoruesve në formë të printuar, ose në formë elektronike, përfshirë publikimin e tij në faqen e internetit të shoqërisë. Një dokument (ose një kombinim i dokumenteve) mund të përmbushë përkufizimin e një raporti vjetor, pavarësisht mënyrës që është përdorur për ta vënë në dispozicion të përdoruesve.
- A5. Një raport vjetor ndryshon nga raportet e tjera për shkak të natyrës, qëllimit dhe përmbajtjes së tij, siç mund të jetë një raport i përgatitur për të përmbushur nevojat për informacione të një grupi të palëve të interesuara (stakeholders) të caktuar ose një raport i përgatitur për të qenë në pajtim me një objektiv specifik të raportimit për qëllime rregullatore (madje edhe në se kërkohet që këto raporte të bëhen publike). Shembuj të raporteve, të cilat kur publikohen si dokumente të veçantë, si rregull, nuk janë pjesë e kombinimit të dokumenteve që përfshihen në një raport vjetor (që kërkohen nga ligji, rregullat apo praktika) dhe që për këtë arsye, nuk janë informacione të tjera brenda objektit të këtij SNA-je, përfshijnë:
- Raportet e sektorëve të veçantë ose raportet për rregullatorët (për shembull, raportet për mjaftueshmërinë e kapitalit), siç janë ato që mund të përgatiten për bankat, shoqëritë e sigurimeve dhe industritë e pensioneve
 - Raportet për përgjegjësinë sociale të shoqërive tregtare.
 - Raportet për qëndrueshmërinë.
 - Raportet për diversitetin dhe mundësitë e barabarta.
 - Raportet për produkte të përgjegjshme.
 - Raportet mbi praktikën e punës dhe kushtet e punës.
 - Raportet mbi të drejtat e njeriut

Anomalia në informacionet e tjera (Ref: Para. 12(b))

- A6. Kur një çështje e veçantë shpjegohet në informacionet e tjera, këto informacione mund të lenë jashtë ose mund të mos zbulojnë ato informacione, të cilat janë të nevojshme për të kuptuar si duhet këtë çështje. Për shembull, në qofte se informacionet e tjera pretendojnë të adresojnë treguesit kryesorë të performancës, të përdorur nga drejtimi, atëherë lënia jashtë e një treguesi kryesor të performancës të përdorur nga drejtimi, mund të tregojë se informacionet e tjera janë çorientuese.
- A7. Koncepti i materialitetit për informacionet e tjera, mund të jetë trajtuar nga një kuadër i zbatueshëm, dhe nëse është kështu, ky kuadër mund të japë një bazë reference për audituesin, që ai të gjykojë në lidhje me materialitetin, sipas këtij SNA-je. Megjithatë, në shumë raste mund të mos ketë një kuadër të zbatueshëm që trajton konceptin e materialitetit për informacionet e tjera. Në këto rrethana, karakteristikat e mëposhtme i japin audituesit një bazë reference për të përcaktuar nëse një anomali në informacionet e tjera, është materiale:
- Materialiteti vlerësohet në kontekstin e nevojave për informacione të përbashkëta të përdoruesve të trajtuar si grup. Përdoruesit e informacioneve të tjera parashikohet të jenë të njëjtë me përdoruesit e pasqyrave financiare dhe këta përdorues mund të pritet të lexojnë informacionet e tjera për të patur një kontekst për pasqyrat financiare.
 - Gjykimet për materialitetin mbajnë parasysh rrethanat specifike të anomalisë, duke vlerësuar nëse do të influencohen përdoruesit nga efektet e anomalive të pakorrigjuara. Jo të gjitha anomali të do të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve.
 - Gjykimet për materialitetin mbajnë parasysh aspektet sasiore dhe cilësore. Për rrjedhojë, këto gjykime mund të mbajnë parasysh natyrën ose madhësinë e elementeve që adresojnë informacionet e tjera në kontekstin e raportit vjetor.

Informacione të tjera (Ref: Para. 12(c))

- A8. Shtojca 1 përmban shembuj të shumave ose elementeve të tjera, të cilat mund të përfshihen në informacionet e tjera.
- A9. Në disa raste, kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar mund të kërkojë dhënien e informacioneve shpjeguese specifike, por lejon që këto informacione të vendosen jashtë pasqyrave financiare⁵. Meqenëse këto informacione kërkohen nga kuadri i

⁵ Për shembull, Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar (SNRF) 7, *Instrumentet financiare, Dhënia e informacioneve shpjeguese*, lejon që disa informacione shpjeguese të kërkuara nga SNRF-të, të jepen ose në pasqyrat financiare, ose të inkorporohen me referencë të kryqëzuar nga pasqyrat financiare tek disa raporte të tjera, siç janë një komentari i drejtimit ose një raport i rrezikut, i cili ju është vënë në dispozicion përdoruesve të pasqyrave financiare me kushte të njëjta, si edhe pasqyrat financiare dhe në të njëjtën kohë.

zbatueshëm i raportimit financiar, ato janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare. Kështu që, për qëllime të këtij SNA-je, ato nuk konsiderohen informacione të tjera.

A10. Sikurse përkufizohet në këtë SNA, etiketa e gjuhës së zgjeruar të raportimit të biznesit (XBRL) nuk përfaqëson informacione të tjera.

Sigurimi (mbledhja) e/i informacioneve të tjera (Ref: Para. 13)

A11. Përcaktimi i dokumenteve që janë pjesë apo përfshihen në raportin vjetor shpesh është e qartë, pasi buron nga ligji, rregullat ose praktika, në shumë raste drejtimi dhe personat e ngarkuar me qeverisjen mund ta kenë praktikë të tyre, ose mund të jenë të angazhuar, të publikojnë një paketë të dokumenteve, të cilat së bashku përfshihen në raportin vjetor. Megjithatë, në disa raste të tjera mund të mos jetë e qartë se cilat dokumente janë pjesë përbërëse ose përfshihen në raportin vjetor. Në këto raste, afatet dhe qëllimi i dokumenteve (dhe për cilët ato janë adresuar) janë aspekte që mund të jenë të përshtatshme për audituesin për të përcaktuar se cili prej dokumenteve është pjesë ose do të përfshihet në raportin vjetor.

A12. Kur raporti vjetor, në zbatim të kërkesave ligjore ose rregullatore është përkthyer në gjuhë të tjera (siç është rasti kur në një juridiksion ka më shumë se një gjuhë zyrtare), ose kur janë përgatitur disa "raporte vjetore", që kërkohen nga ligje të ndryshme (për shembull, kur një entitet është listuar në më shumë se një juridiksion), duhet të mbahet parasysh nëse një, ose më shumë se një nga "raportet vjetore" janë pjesë e informacioneve të tjera. Ligjet ose rregullat lokale mund të japin udhëzime të mëtejshme në këtë drejtim.

A13. Përgjegjësia për përgatitjen e raportit vjetor është e drejtimit ose e personave të ngarkuar me qeverisjen. Audituesi mund të komunikojë me drejtimin ose me personat e ngarkuar me qeverisjen për:

- Pritshmëritë e audituesit në lidhje me marrjen e versionit përfundimtar të raportit vjetor (përfshirë një kombinim të dokumenteve, të cilat së bashku përbëjnë raportin vjetor) në kohën e duhur para datës së raportit të audituesit, në mënyrë që audituesi të mund të kryejë procedurat e kërkuara nga ky SNA para datës së raportit të audituesit, ose kur kjo nuk është e mundur, sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast para se këto informacione të publikohen nga entiteti.
- Pasojat e mundshme, kur informacionet e tjera janë marrë pas datës së raportit të audituesit.

A14. Komunikimet e përmendura në paragrafin A13 mund të jenë veçanërisht të përshtatshme për shembull:

- Në një angazhim fillestar të auditimit.

- Kur ka pasur një ndryshim të drejtuesve ose të personave të ngarkuar me qeverisjen e entitetit.
- Kur informacionet e tjera pritet të merren pas datës së raportit të audituesit.

A15. Kur personat e ngarkuar me qeverisjen duhet të miratojnë informacionet e tjera para se ato të publikohen nga entiteti, versioni final i informacioneve të tjera është ai që është miratuar për publikim nga personat e ngarkuar me qeverisjen.

A16. Në disa raste, raporti vjetor i entitetit mund të jetë një dokument i vetëm, i cili sipas ligjit, rregullave ose praktikës së raportimit të entitetit, do të dalë (publikohet) menjëherë pas periudhës së raportimit financiar të entitetit, me qëllim që t'i vihet në dispozicion audituesit para datës së raportit të audituesit. Në raste të tjera, një dokument i tillë mund të mos kërkohet të publikohet deri në një datë të mëvonshme që përcaktohet nga entiteti. Mund të ketë raste kur raporti vjetor i entitetit të jetë një kombinim i disa dokumenteve, ku secili prej tyre i nënshtrohet kërkesave ose praktikave të ndryshme të raportimit, në lidhje me kohën e publikimit të tyre.

A17. Mund të ketë raste kur në datën e raportit të audituesit, entiteti po shqyrton përgatitjen/zhvillimin e një dokumenti, i cili mund të jetë pjesë e raportit të tij vjetor (për shembull, një raport vullnetar për palët e interesit (stakeholderat)), por drejtimi i tij nuk është në gjendje për t'i konfirmuar audituesit qëllimin apo kohën e publikimit të këtij dokumenti. Nëse audituesi nuk është në gjendje të përcaktojë qëllimin apo kohën e këtij dokumenti, atëherë ky dokument nuk konsiderohet si pjesë e informacioneve të tjera për qëllime të këtij SNA-je.

A18. Marrja e informacione të tjera në kohën e duhur, para datës së raportit të audituesit, bën të mundur kryerjen e rishikimeve të nevojshme në pasqyrat financiare, raportin e audituesit, ose informacionet tjera, përpara publikimit të tyre. Letra e angazhimit të auditimit⁶ mund të ketë një referencë për një marrëveshje të audituesit me drejtimin, sipas së cilës, ky i fundit do t'i japë audituesit informacionet e tjera në kohën e duhur dhe, kur është e mundur, para datës së raportit të audituesit.

A19. Në rastet kur informacionet e tjera janë vënë në dispozicion të përdoruesve vetëm nëpërmjet faqes së internetit të entitetit, versioni i informacioneve të tjera të siguruara nga entiteti, dhe jo ato të marra drejtpërdrejt nga faqja e internetit e entitetit, është dokumenti i përshtatshëm, mbi të cilin audituesi do të kryejë procedurat në përputhje me këtë SNA. Sipas këtij SNA-je audituesi nuk ka përgjegjësi për të kërkuar për informacione të tjera, përfshirë informacionet e tjera që mund të kenë dalë në faqen e internetit të entitetit, dhe as për të kryer ndonjë procedurë për të konfirmuar që informacionet e tjera janë paraqitur në mënyrën e duhur në faqen e internetit të entitetit, ose përndryshe janë transmetuar dhe paraqitur si duhet në mënyrë elektronike.

⁶ SNA 210, Rënia dakord me kushtet e angazhimit të auditimit, paragrafi A23

A20. Mos marrja e një pjese ose e të gjithë informacioneve të tjera nuk e pengon audituesin të vendosë datën dhe të lëshojë raportin e audituesit.

A21. Kur informacionet e tjera janë marrë pas datës së raportit të audituesit, audituesi nuk kërkohet të aktualizojë procedurat e kryera në përputhje me paragrafët 6 dhe 7 të SNA 560⁷.

A22. SNA 580⁸ përcakton kërkesat dhe jep udhëzime për përdorimin e deklarimeve me shkrim. Deklarimet me shkrim, të cilat duhet të kërkohen sipas paragrafit 13(c), në lidhje me informacionet e tjera që do të jenë disponibël vetëm pas datës së raportit të audituesit, kanë për qëllim të mbështesin audituesin për të përfunduar procedurat e kërkuara nga ky SNA në lidhje me këto informacione. Përveç kësaj, audituesi mund ta shikojë të dobishme të kërkojë deklarime të tjera me shkrim, për shembull, që:

- Drejtimi e ka informuar audituesin për të gjitha dokumentet që pritet të publikojë, të cilat mund të përfshihen në informacionet e tjera;
- Pasqyrat financiare dhe çdo informacion tjetër, i marrë nga audituesi para datës së raportit të audituesit, janë në koherencë me njëri-tjetrin, dhe se informacionet e tjera nuk përmbajnë asnjë anomali materiale; dhe
- Në lidhje me informacionet e tjera, të cilat nuk janë marrë nga audituesi para datës së raportit të audituesit, se drejtimi parashikon t'i përgatitë dhe publikojë këto informacione të tjera dhe për kohën e pritshme të publikimit.

Leximi dhe vlerësimi i informacioneve të tjera (Ref: Para. 14-15)

A23. Sipas SNA 200⁹, audituesi kërkohet planifikojë dhe kryejë auditimin me skepticizëm profesional. Mbajtja e skepticizmit profesional, kur lexon dhe vlerëson informacionet e tjera, përfshin, për shembull, njohjen e faktit që drejtimi mund të jetë më tepër se duhet optimist në lidhje me suksesin e planeve të tij, vigjilencën ndaj informacioneve që mund të mos jenë në koherencë me:

(a) Pasqyrat financiare; ose

(b) Njohuritë që audituesi ka marrë gjatë auditimit.

A24. Në përputhje me SNA 220¹⁰, ortaku i angazhimit duhet të marrë përgjegjësinë për drejtimin, mbikëqyrjen dhe kryerjen e angazhimit të auditimit në pajtim me standardet profesionale dhe kërkesat e zbatueshme ligjore e rregullatore. Në kontekstin e këtij

⁷ SNA 560, *Ngjarjet e Mëvonshme*

⁸ SNA 580, *Deklarimet me shkrim*

⁹ SNA200, paragrafi 15

¹⁰ SNA 220, *Kontrulli i cilësisë për një auditim të pasqyrave financiare*, paragrafi 15 (a)

SNA-je, kur përcaktohen anëtarët e duhur të grupit të angazhimit, për të adresuar kërkesat e paragrafëve 14-15, mund të mbahen parasysh faktorët e mëposhtëm:

- Përvojat relative të anëtarëve të grupit të angazhimit
- Nëse anëtarët e grupit të angazhimit, të cilëve ju ngarkohen detyra për t'i kryer, zotërojnë njohuritë e duhura të marra gjatë auditimit, për të identifikuar inkoherencat midis informacioneve të tjera dhe njohurive të tyre.
- Nivelin e gjykimit që përdoret për trajtimin e kërkesave të paragrafëve 14-15. Për shembull, kryerja e procedurave për të vlerësuar koherencën e shumave në informacionet e tjera, që kanë për qëllim të provojnë se ato janë të njëjta me shumat në pasqyrat financiare, mund të kryhen nga anëtarët e grupit të angazhimit me më pak përvojë.
- Nëse, në rastin e një auditimi të grupit, është e nevojshme për të bërë kërkesa për informacione tek një auditues i komponentit, për të trajtuar informacionet e tjera që lidhen me këtë komponent.

Vlerësimi nëse ka një inkoherencë (mospërputhje) materiale midis Informacioneve të tjera dhe Pasqyrave Financiare (Ref: Para. 14 (a))

A25. Informacionet e tjera mund të përfshijnë shumat ose zërat e tjerë, që parashikohet të jenë të njëjtë, në trajtë të përmbledhur, ose më të detajuar, me shumat apo zërat e tjerë në pasqyrat financiare. Shembuj të këtyre shumave apo zërave (elementeve) janë:

- Tabelat, grafikët, ose skicat që përmbajnë ekstrakte të pasqyrave financiare.
- Një informacion shpjegues, i cili jep më shumë detaje për një tepricë ose llogari të paraqitur në pasqyrat financiare, si për shembull “Të ardhurat për 20X1 përfshijnë XXX milion nga produkti X dhe YYY milion nga produkti Y”.
- Përshkrimet e rezultateve financiare, si për shembull “Shpenzimet totale për kërkimin dhe zhvillimin në vitin 20X1 ishin XXX”.

A26. Për të vlerësuar koherencën e shumave të zgjedhura apo zërave të tjerë në informacionet e tjera me pasqyrat financiare, audituesi nuk kërkohet të krahasojë të gjitha shumat ose zërat e tjera në informacionet e tjera që parashikohet të jenë të njëjtë, për të përmbledhur, ose për të siguruar detaje më të mëdha në lidhje me shumat apo zërat e tjera në pasqyrat financiare, me shumat apo zëra të tillë në pasqyrat financiare.

A27. Përzgjedhja e shumave ose e zërave të tjerë që duhet të krahasohen është një çështje e gjykimit profesional. Për këtë gjykim duhet të mbahen parasysh faktorët e mëposhtëm:

PËRGJEGJËSITË E AUDITUESIT NË LIDHJE ME INFORMACIONET E TJERA

- Rëndësia e shumës ose zërit tjetër në kontekstin në të cilin ajo/ai është paraqitur, e cila mund të ndikojë në rëndësinë që përdoruesit do t'i bashkëngjitin shumës ose zërit tjetër (për shembull, një raport ose shumë, e rëndësishme).
- Nëse shuma është sasiore, madhësia relative e saj, krahasuar me llogaritë apo zërat në pasqyrat financiare ose informacionet e tjera, me të cilat ato lidhen.
- Ndjeshmëria e shumës së veçantë apo zërit tjetër në informacionet e tjera, për shembull, pagesat e bazuara në aksione për drejtuesit kryesorë.

A28. Përcaktimi i natyrës dhe shtrirjes së procedurave për të adresuar kërkesën në paragrafin 14(a) është një çështje e gjykimit profesional, që pranon se përgjegjësitë e audituesit sipas këtij SNA-je nuk nënkuptojnë kryerjen e një angazhimi të sigurisë për informacionet e tjera dhe as imponojnë një detyrim për të dhënë siguri për informacione të tjera. Shembuj të këtyre procedurave përfshijnë:

- Për informacionet që parashikohet të jenë të njëjta me të dhënat në pasqyrat financiare, bëhet krahasimi i informacioneve me pasqyrat financiare.
- Për informacionet që parashikohet të kenë kuptim të njëjtë me informacionet shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare, krahasohen fjalët e përdorura dhe vlerësohet shkalla e diferencave në formulimin e përdorur dhe nëse këto ndryshime nënkuptojnë kuptime të ndryshme.
- Sigurimi i një rakordimi që drejtimi ka bërë midis një shume brenda informacioneve të tjera me të dhënat në pasqyrat financiare, dhe:
 - Krahasimi zërave të rakorduar me pasqyrat financiare dhe informacionet e tjera; dhe
 - Kontrolli nëse llogaritjet brenda rakordimit janë aritmetikisht të sakta.

A29. Vlerësimi i qëndrueshmërisë së shumave të zgjedhura apo zërave të tjerë në informacionet e tjera me pasqyrat financiare përfshin, kur është e nevojshme duke pasur parasysh natyrën e informacioneve të tjera, mënyrën e paraqitjes së tyre krahasuar me pasqyrat financiare.

Vlerësimi nëse ka një mospërputhje materiale midis informacioneve të tjera dhe njohurive të audituesit të siguruara gjatë auditimit (Ref: Para. 14 (b))

A30. Informacionet e tjera mund të përfshijnë shumat ose zërat, të cilat janë të lidhura me njohuritë që audituesi ka marrë gjatë auditimit (të ndryshme nga ato në paragrafin 14(a)). Shembuj të këtyre shumave apo zërave janë:

- Një informacion për njësitë e prodhuara, apo një tabelë që përmbledh prodhimin sipas zonave gjeografike.

- Një deklaratë se “Shoqëria ka hedhur në prodhim gjate këtij viti produktet X dhe Y”.
- Një përmbledhje të vendndodhjeve kryesore të operacioneve të entitetit, si për shembull: Qendra kryesore e operacioneve të entitetit në vendin X dhe ka operacione edhe në vendet Y dhe Z.”

A31. Njohuritë që audituesi ka marrë gjatë auditimit përfshijnë njohjen dhe kuptimin që ai ka për entitetin dhe mjedisin e tij, duke përfshirë edhe kontrollin e brendshëm të entitetit, të marra në përputhje me SNA 315 (i rishikuar)¹¹. SNA 315 (i rishikuar) përcakton njohjen dhe kuptimin që duhet të ketë audituesi, e cila përfshin çështje të tilla si marrja e njohurive për:

- (a) Faktorët që lidhen me sektorin përkatës të ekonomisë, faktorët rregullatorë dhe faktorë të tjerë të jashtëm;
- (b) Natyrën e entitetit;
- (c) Përzgjedhjen dhe zbatimin e politikave kontabël të entitetit;
- (d) Objektivat dhe strategjitë e entitetit;
- (e) Matjen dhe rishikimin e performancës financiare të entitetit; dhe
- (f) Kontrollin e brendshëm të entitetit.

A32. Njohuritë që audituesi merr gjatë auditimit mund të përfshijnë çështje, të cilat për nga natyra lidhen me periudha të ardhshme. Këto çështje mund të përfshijnë, për shembull, parashikimet e veprimtarisë së biznesit dhe të flukseve të ardhshme të parasë që audituesi ka mbajtur parasysh kur ka bërë vlerësimin e supozimeve të përdorura nga drejtimi në kryerjen e testeve të zhvlerësimit për aktivet jo-materiale, siç është emri i mirë, ose kur audituesi ka vlerësuar drejtimin për mënyrën se si ky i fundit ka përcaktuar aftësinë e entitetit për të vazhduar veprimtarinë në vijimësi.

A33. Kur vlerëson nëse ka një mospërputhje (inkoherencë) materiale midis informacioneve të tjera dhe njohurive që audituesi ka marrë gjatë auditimit, audituesi mund të fokusohet në ato çështje të informacioneve të tjera, të cilat paraqesin rëndësi të mjaftueshme për ta konsideruar materiale një anomali të informacioneve të tjera në lidhje me këtë çështje.

A34. Për shumë çështje në informacionet e tjera, mund të mjaftojë rishqyrtimi i evidencës së auditimit të siguruar dhe i përfundimeve të arritura gjatë auditimit, që audituesi të jetë

¹¹ SNA 315 (i rishikuar), *Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të anomalisë materiale nëpërmjet njohjes së entitetit dhe mjedisit të tij*, paragrafët 11-12

në gjendje të vlerësojë nëse ka një mospërputhje materiale midis informacioneve të tjera dhe njohurive të audituesit të marra gjatë auditimit. Sa më shumë përvojë dhe sa më shumë i familjarizuar të jetë audituesi me aspektet kryesore të auditimit, aq më shumë ka të ngjarë që për çështjet përkatëse të mjaftoje rishqyrtimi i audituesit. Për shembull, audituesi mund të jetë në gjendje të vlerësojë nëse ka një mospërputhje materiale midis informacioneve të tjera dhe njohurive të tij të marra gjatë auditimit në dritën e rishqyrtimeve dhe diskutimeve që audituesi ka patur me drejtimin ose me personat e ngarkuar me qeverisjen, apo të gjetjeve nga procedurat e kryera gjatë auditimit siç janë leximi i procesverbaleve të mbledhjeve të bordit, pra pa qenë nevoja për të kryer veprime të tjera.

A35. Audituesi mund të arrijë në konkluzionin se bazë e përshtatshme për të vlerësuar nëse ekziston një mospërputhje materiale, do të ishte referimi tek dokumentacioni përkatës i auditimit, ose marrja e informacioneve prej anëtarëve të grupit të angazhimit apo audituesit përkatës të komponentit. Për shembull:

- Kur informacionet e tjera përshkruajnë ndërprerjen e planifikuar të një linje kryesore të produktit por, megjithëse audituesi është në dijeni të ndërprerjes së planifikuar, ai mund të bëjë kërkesa për të marrë informacione nga anëtari përkatës i grupit të angazhimit, i cili ka kryer procedurat e auditimit në këtë fushë për të mbështetur vlerësimin e audituesit nëse përshkrimi ka mospërputhje materiale me njohuritë që audituesi ka marrë gjatë auditimit.
- Kur informacionet e tjera përshkruajnë detaje të rëndësishme të një padie gjyqësore të trajtuar gjatë auditimit, por që audituesi nuk mund ta trajtojë në mënyrë të mjaftueshme, mund të jetë e nevojshme që ai t'i referohet dokumentacionit të auditimit, ku jepen detaje të përmbledhura për të mbështetur rishqyrtimin e audituesit.

A36. Nëse audituesi, dhe nëse po, në atë masë në të cilën, i referohet dokumentacionit përkatës të auditimit, ose ju kërkon informacione anëtarëve të grupit përkatës të angazhimit apo audituesve përkatës të komponentit, është një çështje e gjykimit profesional. Megjithatë, në lidhje me ndonjë çështje të përfshirë në informacionet e tjera, mund të mos jetë e nevojshme që audituesi t'i referohet dokumentacionit përkatës të auditimit, ose të kërkojë informacione nga anëtarët e grupit të angazhimit apo audituesit e komponentit.

Vigjilenca ndaj shenjave të tjera që tregojnë se informacionet e tjera duket se kanë anomali materiale (Ref: Para. 15)

A37. Informacionet e tjera mund të përfshijnë diskutimet për çështjet që nuk janë të lidhura me pasqyrat financiare dhe mund të shkojnë përtej njohurive që ka marrë audituesi gjatë auditimit. Për shembull, informacionet e tjera mund të përfshijnë deklaratat (pasqyrat) e entitetit për emetimet e gazrave serë.

A38. Vigjilenca ndaj indikacioneve të tjera që tregojnë se informacionet e tjera, të cilat nuk kanë lidhje me pasqyrat financiare apo me njohuritë e audituesit të marra gjatë auditimit, duket se kanë anomali materiale, e ndihmon audituesin për të qenë në pajtim me kërkesat përkatëse etike, të cilat kërkojnë që audituesi të shmangë një lidhje të vullnetshme me informacionet e tjera, për të cilat ai beson se përmbajnë një deklaratë materiale false ose mashtruese, një deklaratë çorientuese ose të bërë nga pakujdesia, ose mungesa apo fshehje të informacioneve të nevojshme, në një mënyrë të atillë që informacionet e tjera të çorientojnë (mashtrojnë)¹². Vigjilenca ndaj shenjave të tjera që tregojnë se informacionet e tjera duket se kanë anomali materiale, potencialisht mund të bejë që audituesi ti identifikojë këto çështje si:

- Diferenca midis informacioneve të tjera dhe njohurive të përgjithshme, përveç njohurive të marra gjatë auditimit, nga anëtarët e grupit të angazhimit gjatë leximit të informacioneve që e bëjnë audituesin të besojë se informacionet e tjera duket se kanë anomali materiale; ose
- Mospërputhje (inkoherenca) të brendshme në informacionet e tjera që e bëjnë audituesin të besojë se informacionet e tjera duket se kanë anomali materiale.

Reagimi kur duket se ekziston një inkoherencë (mospërputhje) materiale ose kur informacionet e tjera duket se kanë anomali materiale (Ref: Para. 16)

A39. Diskutimet që audituesi bën me drejtimin lidhur me një mospërputhje materiale (ose për informacionet e tjera që duket se janë me anomali materiale) mund të përfshijnë kërkesën për drejtimin, për të mbështetur bazën mbi të cilën janë bërë deklaratat e drejtimit në informacionet e tjera. Bazuar në informacionet e mëtejshme ose në shpjegimet e drejtimit, audituesi mund të krijojë bindjen se informacionet e tjera nuk përmbajnë anomali materiale. Për shembull, shpjegimet e drejtimit mund të tregojnë se ka baza të arsyeshme dhe të mjaftueshme që justifikojnë diferencat në gjykim.

A40. Nga ana tjetër, diskutimet me drejtimin mund të japin informacione të mëtejshme, të cilat mbështesin përfundimin e audituesit se në informacionet e tjera ekziston një anomali materiale.

A41. Për audituesin mund të jetë më e vështirë të sfidojë drejtimin për çështjet e gjykimit krahasuar me çështjet e tjera të natyrës së faktimit të të dhënave. Megjithatë, mund të ketë rrethana kur audituesi konkludon se informacionet e tjera përmbajnë një deklaratë, e cila nuk është në koherencë me pasqyrat financiare apo me njohuritë që audituesi ka marrë gjatë auditimit. Këto rrethana mund të ngrenë dyshime në lidhje me informacionet e tjera, pasqyrat financiare, ose njohuritë e audituesit të marra gjatë auditimit.

A42. Duke qenë se ekziston një gamë e gjerë e anomalive materiale të mundshme në informacionet e tjera, natyra dhe shtrirja e procedurave të tjera që audituesi mund të

¹² Kodi i Etikës i BSNEPK-së, paragrafi 110.2

kryejë për të konkluduar nëse në informacionet e tjera ekziston një anomali materiale, janë çështje të gjykimit profesional të audituesit sipas rrethanave të angazhimit.

A43. Kur një çështje nuk ka lidhje me pasqyrat financiare apo me njohuritë që audituesi ka marrë gjatë auditimit, audituesi mund të mos jetë plotësisht në gjendje të vlerësojë përgjigjet e drejtimit kundrejt kërkesave për informacione/pyetjeve të audituesit. Megjithatë, bazuar në informacionet apo shpjegimet e mëtejshme të drejtimit, ose duke parë ndryshimet që drejtimi ju ka bërë informacioneve të tjera, audituesi mund të krijojë bindjen se duket se nuk ka një mospërputhje (inkoherencë) materiale, ose që informacionet e tjera duket se nuk kanë më anomali materiale. Kur audituesi nuk është në gjendje të arrijë në përfundimin se duket se nuk ka më një inkoherencë (mospërputhje) materiale ose se informacioni tjetër nuk duket se ka më anomali materiale, audituesi mund t'i kërkojë drejtimit të konsultohet me një palë të tretë të kualifikuar (për shembull, një ekspert të drejtimit ose një këshilltar ligjor). Në disa raste, pas shqyrtimit të përgjigjeve nga konsultimi me drejtimitin, audituesi mund të mos jetë në gjendje të konkludojë nëse ka ose jo një anomali materiale në informacionet e tjera. Veprimet e tjera që audituesi mund të ndërmarrë përfshijnë një ose më shumë nga sa më poshtë vijon:

- Marrja e këshillave nga këshilltarët ligjorë të audituesit;
- Shqyrtimi i ndikimeve në raportin e audituesit për shembull, nëse ai do të përshkruajë në raport rrethanat kur ka një kufizim të imponuar nga drejtimi; ose
- Heqja dorë nga auditimi, ku tërheqja është e mundur në bazë të ligjit ose rregullave të zbatueshme.

Reagimi kur audituesi arrin në përfundimin se në informacionet e tjera ekziston një anomali materiale

Reagimi kur audituesi arrin në përfundimin se ekziston një anomali materiale në informacionet e tjera, të siguruara para datës së raportit të audituesit (Ref: Para. 18)

A44. Veprimet që ndërmerr audituesi, nëse pas komunikimit me personat e ngarkuar me qeverisjen nuk janë korrigjuar informacionet e tjera, janë një çështje të gjykimit të tij profesional. Audituesi mund të marrë në konsideratë faktin nëse arsyetimet e dhëna nga drejtimi dhe personat e ngarkuar me qeverisjen, ngrenë dyshime mbi integritetin apo ndershmërinë e drejtimit ose të personave të ngarkuar me qeverisjen, siç janë rastet kur audituesi dyshon për një shmangie/çorientim të qëllimshme. Gjithashtu audituesi mund ta shohë të përshtatshme të mbajë parasysh edhe nevojën për të kërkuar këshilla ligjore. Në disa raste, nga ligji ose rregullat apo nga standardet e tjera profesionale, mund të kërkohej që audituesi të komunikojë çështjen tek një autoritet rregullator ose tek organizmi profesional përkatës.

Ndikimet në raportim (Ref: Para. 18 (a))

A45. Në raste të rralla, kur refuzimi për të korrigjuar gabimet materiale të informacioneve të tjera ngre dyshime mbi integritetin e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen, të atilla që vënë në dyshim besueshmërinë e evidencës së auditimit në përgjithësi, mund të jetë e përshtatshme të jepet një opinion kundër mbi pasqyrat financiare.

Tërheqja nga Angazhimi (Ref: Para. 18 (b))

A46. Kur rrethanat që lidhen me refuzimin për të korrigjuar anomalitë materiale të informacioneve të tjera hedhin dyshime mbi integritetin e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen, që venë në dyshim besueshmërinë e deklarimeve të marra prej tyre gjatë auditimit, do të ishte e përshtatshme që audituesi të tërhiqet nga angazhimi, kur kjo gjë është e mundur sipas ligjeve ose rregullave të zbatueshme.

Konsiderata të veçanta për entitetet e sektorit publik (Ref: Para. 18 (b))

A47. Tërheqja nga angazhimi mund të mos jetë e mundur në sektorin publik. Në këto raste, audituesi mund të lëshojë një raport për legjislativin (kuvendin) duke dhënë detaje për çështjen ose mund të ndër marrë veprime të tjera të përshtatshme.

Reagimet kur audituesi arrin në përfundimin se, në informacionet e tjera të siguruara pas datës së raportit të audituesit, ka një anomali materiale (Ref: Para. 19)

A48. Nëse audituesi arrin në përfundimin se në informacionet e tjera të marra pas datës së raportit të audituesit, ka një anomali materiale, dhe kjo anomali materiale është korrigjuar, procedurat e nevojshme për rrethanat, të cilat duhet të kryejë audituesi përfshijnë verifikimin nëse është bërë korrigjimi (në përputhje me paragrafin 17 (a)) dhe mund të përfshijnë edhe rishikimin e hapave të ndërmarrë nga drejtimi për të komunikuar me marrësit e informacioneve të tjera, nëse ato janë publikuar më parë, për t'i informuar ata lidhur me rishikimin e bërë.

A49. Nëse personat e ngarkuar me qeverisjen nuk pranojnë të rishikojnë informacionet e tjera, ndërmarrja e masave të duhura për të kërkuar që anomalitë e pakorrigjuara në mënyrën e duhur, të sillen në vëmendjen e përdoruesve, për të cilët është përgatitur raporti i audituesit, kërkon ushtrimin e gjykimit profesional, dhe mund të ndikohet nga ligjet e rregullat e zbatueshme në juridiksionin përkatës. Për rrjedhojë, audituesi mund të gjykojë si të përshtatshme marrjen e këshillave ligjore lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tij ligjore në një rast të tillë.

A50. Kur një anomali materiale në informacionet e tjera mbetet e pakorrigjuar, veprimet e duhura që audituesi mund të ndër marrë për të kërkuar që anomalitë e pakorrigjuara në mënyrën e duhur, të sillen në vëmendjen e përdoruesve, për të cilët është përgatitur raporti i audituesit, kur lejohen nga ligjet ose rregullat, përfshijnë, për shembull:

- Lëshimin për drejtimin të një raporti të audituesit të ri ose të modifikuar, i cili përfshin një seksion të modifikimit në përputhje me paragrafin 22, të shoqëruar me kërkesën për drejtimin që ky i fundit ta dërgojë tek përdoruesit për të cilët është përgatitur raporti i audituesit. Duke vepruar në këtë mënyrë, audituesi mund të ketë nevojë të marre në konsideratë efektin, nëse ka, mbi datën e raportit të audituesit të ri ose të modifikuar, të parë në dritën e kërkesave të SNA-ve ose ligjeve apo rregullave të zbatueshme. Gjithashtu, audituesi mund të rishikojë hapat që ka ndërmarrë drejtimi për dërgimin e raportit të audituesit të ri ose të modifikuar tek këta përdorues;
- Sjelljen në vëmendjen e përdoruesve, për të cilët është përgatitur raporti i audituesit, të anomalive materiale të informacioneve të tjera, (për shembull, duke e adresuar këtë çështje në një mbledhje të përgjithshme të aksionarëve);
- Komunikimin, në lidhje me anomalitë materiale të pakorrigjuara, me një rregullator ose me organizmin përkatës profesional; ose
- Marrjen në konsideratë të ndikimeve në vazhdimësinë e angazhimit (shih gjithashtu paragrafin A46).

Reagimi kur ekziston një anomali materiale në pasqyrat financiare ose kur duhet të aktualizohet njohja e audituesit për entitetin dhe mjedisin e tij. (Ref: Para. 20)

A51.Gjatë leximit të informacioneve të tjera, audituesi mund të vihet në dijeni të informacioneve të reja, që kane pasoja mbi:

- Të kuptuarit/njohjen e audituesit në lidhje me entitetin dhe mjedisin e tij dhe, rrjedhimisht, mund të jetë tregues i nevojës për të rishikuar vlerësimin e rrezikut të bërë nga audituesi¹³.
- Përgjegjësinë e audituesit për të vlerësuar efektin e anomalive të identifikuara në auditim dhe të anomalive të pakorrigjuara, nëse ka, në pasqyrat financiare¹⁴.
- Përgjegjësitë e audituesit në lidhje me ngjarjet e mëvonshme¹⁵.

Raportimi (Ref: Para. 21-24)

A52.Për një auditim të pasqyrave financiare të një entiteti të pa listuar, audituesi mund të vlerësojë se, identifikimi në raportin e audituesit, i informacioneve të tjera që ai parashikon të marrë pas datës së raportit të audituesit, do të ishte i përshtatshëm për të siguruar transparencë shtesë në lidhje me informacionet e tjera, që janë subjekt i përgjegjësisive të audituesit sipas këtij SNA-je. Audituesi mund ta konsiderojë të

¹³ SNA 315 (i rishikuar), paragrafët 11, 31 dhe A1

¹⁴ SNA 450, *Vlerësimi i anomalive të identifikuara gjatë auditimit* 15

¹⁵ SNA 560, paragrafët 10 dhe 14

përshtatshme për ta bërë këtë, për shembull, kur drejtimi mund t'i japë deklaratime audituesit se informacionet e tjera do të publikohen pas datës së raportit të audituesit.

Pasqyrat Ilustruese (Ref: Para. 21-22)

A53. Shembujt ilustrues të seksionit "Informacione të Tjera" të raportit të audituesit janë përfshirë në Shtojcën 2.'

Ndikimet në raportin e audituesit, kur opinioni i audituesit për pasqyrat financiare është me rezervë ose kundër (Ref: Para. 23)

A54. Një opinion audituesi mbi pasqyrat financiare me rezervë ose kundër mund të mos ketë një ndikim në deklaratën që kërkohet nga paragrafi 22 (e), në qoftë se çështja për të cilën është modifikuar opinioni i audituesit, nuk është përfshirë ose ndryshe trajtuar në informacionet e tjera dhe, çështja nuk ndikon në ndonjë pjesë të informacioneve të tjera. Për shembull, një opinion me rezervë në pasqyrat financiare për shkak të mosdhënies së informacioneve shpjeguese për shpërblimin e drejtorëve, siç kërkohet nga kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar, mund të mos ketë asnjë ndikim në raportimin e kërkuar sipas këtij SNA-je Në rrethana të tjera, për këtë raportim mund të ketë ndikim, siç përshkruhet në paragrafët A55-A58.

Opinion me rezervë për shkak të një anomalie materiale në pasqyrat financiare

A55. Në rrethanat kur opinioni i audituesit është me rezervë, konsideratë mund t'i jepet faktit nëse informacionet e tjera janë gjithashtu, me anomalie materiale për të njëjtën çështje, apo një çështje të lidhur me çështjen që ka çuar në një opinion me rezervë mbi pasqyrat financiare.

Opinion me rezervë për shkak të kufizimit të objektit/fushëveprimit

A56. Kur ka kufizim të objektit në lidhje me një zë material në pasqyrat financiare, audituesi nuk do të ketë marrë evidencën e nevojshme të auditimit në lidhje me këtë çështje. Në këto rrethana, audituesi mund të mos jetë në gjendje për të konkluduar nëse rezultojnë apo jo në një anomalie materiale në informacionet e tjera, shumat apo zërat e tjera në informacionet e tjera që lidhen me këtë çështje. Për këtë arsye, audituesi mund të ketë nevojë të modifikojë deklaratën e kërkuar nga paragrafi 22 (e) për t'iu referuar pamundësisë së tij për të marrë në shqyrtim përshkrimin e drejtimit për çështjen në informacionet e tjera, për të cilën është modifikuar opinioni i audituesit për pasqyrat financiare, siç shpjegohet në paragrafin e Bazës për opinionin me rezervë. Sidoqoftë, audituesi duhet të raportojë për ndonjë anomalie tjetër materiale të pa korrigjuar të informacioneve të tjera të identifikuar.

Opinionin Kundër

A57 Një opinion kundër mbi pasqyrat financiare në lidhje me një çështje të veçantë të përshkruar në paragrafin e Bazës për opinionin kundër, nuk justifikon mos raportimin në raportin e audituesit të anomalive materiale të informacioneve të tjera që audituesi

ka identifikuar në përputhje me paragrafin 22 (e) (ii). Kur për pasqyrat financiare është shprehur një opinion kundër, audituesi mund të ketë nevojë të modifikojë në mënyrën e duhur deklaratën që kërkohet nga paragrafi 22 (e) për shembull, për të treguar se shumatat ose zërat në informacionet e tjera janë me anomali materiale për të njëjtën çështje si edhe/ ose për një çështje në lidhje me çështjen që ka çuar në opinion kundër mbi pasqyrat financiare.

Refuzimi i Opinioneve

A58. Kur audituesi refuzon të japë një opinion mbi pasqyrat financiare, dhënia e detajeve të mëtejshme në lidhje me auditimin, përfshirë një seksion për të adresuar informacionet e tjera, mund të errësojë refuzimin e opinionit mbi pasqyrat financiare në tërësi. Prandaj, në këto rrethana, ashtu siç kërkohet nga SNA 705 (i rishikuar), raporti i audituesit nuk përfshin një seksion për të adresuar kërkesat e raportimit sipas këtij SNA - je.

Raportimi është përshkruar nga ligji ose rregullat (Ref: Para. 24)

A59.SNA 200 shpjegon se audituesi, përveç atyre që kërkohen në SNA-të, mund të kërkohet të jetë në pajtim edhe me kërkesa të tjera ligjore ose rregullatore. Në një rast të tillë audituesi mund të ketë detyrimin të përdorë një format ose një formulim të raportit të audituesit që ndryshon nga ai i përshkruar në këtë SNA. Kohërencia në raportin e audituesit, kur auditimi është kryer sipas SNA-ve, nxit kredibilitetin në tregun global, pasi i bën më të gatshëm të identifikohen ato auditime që janë kryer në pajtim me standardet e njohura globalisht. Kur diferencat midis kërkesave ligjore ose rregullatore për të raportuar në lidhje me informacionet e tjera dhe këtij SNA-je lidhen vetëm me formatin dhe formulimin në raportin e audituesit, dhe të paktën, çdo element i identifikuar në paragrafin 24 është përfshirë në raportin e audituesit, raporti i audituesit mund të referohet Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Për këtë arsye, në këto rrethana, audituesi konsiderohet se ka qenë në pajtim me këtë SNA, madje edhe në rast se formati dhe formulimi i përdorur në raportin e audituesit janë specifikuar me kërkesa ligjore ose rregullatore të raportimit.

Shtojca 1

(Ref: Para. 14, A8)

Shembuj të shumave ose zërave të tjerë që mund të jenë përfshirë në informacionet e tjera.

Në vijim janë dhënë shembuj të shumave dhe zërave të tjerë që mund të jenë përfshirë në informacionet e tjera. Lista nuk parashikohet të jetë shteruese.

Shumat

- Zërat në një përmbledhje të rezultateve kryesore financiare, siç janë të ardhurat neto, të ardhurat për aksion, dividendët, të ardhurat nga shitjet dhe të ardhura të tjera të shfrytëzimit, dhe blerjet e shpenzimet e shfrytëzimit.
- Të dhëna të zgjedhura të shfrytëzimit, siç janë të ardhurat nga veprimtaritë e vijueshme, ose shitjet sipas segmenteve gjeografike apo linjës së prodhimit.
- Zërat e veçantë, siç janë aktivet e dala nga veprimtaria, provizionet për paditë gjyqësore, rëniet në vlerë të aktivitetit, korrigjimet tatimore, provizionet për mjedisin dhe rikuperimin e tij, dhe shpenzimet për ristrukturimin e organizimit.
- Informacione për burimet e likuiditeteve dhe të kapitalit, siç janë paratë, ekuivalentët e parasë dhe letrat me vlerë të tregtueshme; dividendët; dhe borxhet, detyrimet e qirasë kapitale dhe detyrimet e interesave të minorancës.
- Shpenzimet kapitale sipas segmenteve ose nënndarjeve.
- Shumat, dhe efektet financiare, të përfshira në marrëveshjet jashtë bilancit.
- Shumat e përfshira në garancitë, detyrimet kontraktuale, pretendimet ligjore ose të mjedisit dhe detyrime të tjera eventuale.
- Matësit ose raportet financiare, siç janë kufiri bruto i fitimeve, kthimi mbi mesataren e kapitalit të punësuar, kthimi mbi mesataren e kapitalit të aksionarëve, raporti afatshkurtër (korrent), niveli i mbulimit të interesit dhe niveli i borxhit. Disa prej këtyre mund të rakordohen direkt me pasqyrat financiare

Elementet/zërat e tjerë

- Shpjegimet për çmuarjet kritike kontabël dhe supozimet përkatëse.
- Identifikimi i palëve të lidhura dhe përshkrimi i transaksioneve me to.

- Artikulimi i politikave dhe metodave për menaxhimin e rrezikut të mallrave, kursit të këmbimit në monedhë të huaj ose të niveleve të interesit, si për shembull, duke përdorur kontratat e të ardhmes, kurset e këmbimit swap, ose instrumente të tjera financiare.
- Përshkrimet e natyrës së marrëveshjeve jashtë bilancit.
- Përshkrimi i garancive, primeve të sigurimit, detyrimeve kontraktuale, rastet e detyrimeve të padive gjyqësore ose të mjedisit dhe kontigjencave të tjera, përfshirë vlerësimin e cilësisë së drejtimit për ekspozimet përkatëse të entitetit.
- Përshkrimi i ndryshimeve në kërkesat ligjore dhe rregullore, siç mund të jënë taksat e reja ose rregullat mjedisore, që ndikojnë në mënyrë materiale në veprimtaritë e entitetit ose pozicionin e tij financiar, ose që do të kenë një ndikim material në parashikimet e ardhshme financiare të entitetit.
- Vlerësimet cilësore të drejtimit për ndikimet e standardeve të reja të raportimit financiar, të cilat kanë hyrë në fuqi gjatë periudhës ose që do të hyjnë në fuqi në periudhën në vijim, mbi rezultatet financiare, pozicionin financiar dhe flukset e parasë të entitetit.
- Përshkrimi i përgjithshëm i mjedisit dhe i parashikimit të biznesit.
- Përshkrimi i strategjisë.
- Përshkrimi i prirjeve në çmimet e tregut të mallrave dhe të lëndëve të para kryesore.
- Kontratat e furnizimit, kërkesa dhe kërkesat rregullore midis rajoneve gjeografike.
- Shpjegimi i faktorëve specifikë që influencojnë përfitueshmërinë e entitetit në segmentet specifike

Shtojca 2

(Ref: Para. 21-22, A53)

Ilustrime të Raporteve të Audituesit lidhur me Informacionet e Tjera

Ilustrimi 1 – Një raport i audituesit për një entitet, të listuar ose jo, që përmban një opinion të pamodifikuar, kur audituesi ka siguruar të gjithë informacionet e tjera para datës së raportit të audituesit dhe nuk ka identifikuar një anomali materiale në këto informacione.

Ilustrimi 2 – Një raport i audituesit për një entitet të listuar që përmban një opinion të pamodifikuar, kur audituesi ka siguruar një pjesë të informacioneve të tjera para datës së raportit të audituesit, nuk ka identifikuar një anomali materiale në informacionet e tjera, dhe parashikon të sigurojë pjesën tjetër të informacioneve të tjera pas datës së raportit të audituesit.

Ilustrimi 3 – Një raport i audituesit për një entitet të pa listuar që përmban një opinion të pamodifikuar, kur audituesi ka siguruar një pjesë të informacioneve të tjera para datës së raportit të audituesit, nuk ka identifikuar një anomali materiale në informacionet e tjera, dhe parashikon të sigurojë pjesën tjetër të informacioneve të tjera pas datës së raportit të audituesit.

Ilustrimi 4 – Një raport i audituesit për një entitet të listuar që përmban një opinion të pamodifikuar, kur audituesi nuk ka siguruar asnjë informacion tjetër para datës së raportit të audituesit, por parashikon që informacionet e tjera t'i sigurojë pas datës së raportit të audituesit.

Ilustrimi 5 – Një raport i audituesit për një entitet të listuar ose të pa listuar, që përmban një opinion të pamodifikuar, kur audituesi ka siguruar të gjitha informacionet e tjera para datës së raportit të audituesit dhe ka arritur në përfundimin se në informacionet e tjera ekziston një anomali materiale.

Ilustrimi 6 – Një raport i audituesit për një entitet të listuar ose të pa listuar, që përmban një opinion me rezervë, kur audituesi ka siguruar të gjitha informacionet e tjera para datës së raportit të audituesit dhe ka një kufizim në objekt në lidhje me një element material në pasqyrat financiare të konsoliduara, i cili ndikon edhe në informacionet e tjera.

Ilustrimi 7 – Një raport i audituesit për një entitet të listuar ose të pa listuar, që përmban një opinion kundër, kur audituesi ka siguruar të gjitha informacionet e tjera para datës së raportit të audituesit dhe opinionin kundër mbi pasqyrat financiare të konsoliduara ndikon edhe në informacionet e tjera.

Ilustrimi 1 – Një raport i audituesit për një entitet, të listuar ose jo, që përmban një opinion të pamodifikuar, kur audituesi ka siguruar të gjithë informacionet e tjera para datës së raportit të audituesit dhe nuk ka identifikuar një anomali materiale në këto informacione.

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti të listuar ose jo, që përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi nuk është auditim i një grupi (d.m.th. nuk zbatohet SNA 600¹⁶).
- Pasqyrat financiare janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se duhet të jepet një opinion i pamodifikuar (d.m.th. “i pastër”).
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato që janë në fuqi në juridiksionin përkatës (vendin përkatës).
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të ngrëjë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë, sipas SNA 570 (i rishikuar)¹⁷.
- Çështjet kryesore të auditimit janë komunikuar në pajtim me SNA 701¹⁸.
- Audituesi i ka siguruar të gjitha informacionet e tjera para datës së raportit të audituesit dhe nuk ka identifikuar ndonjë anomali materiale në këto informacione.
- Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Përveç auditimit të pasqyrave financiare, audituesi ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat kërkohen sipas legjislacionit lokal (të vendit përkatës).

¹⁶ SNA 600, *Konsiderata të veçanta – Auditimi i pasqyrave financiare të grupit (duke përfshirë punën e audituesit të entitetit të kontrolluar)*

¹⁷ SNA 570 (i rishikuar), *Vijimësia*

¹⁸ SA 701, *Komunikimi i Çështjeve kryesore të Auditimit në Raportin e Audituesit të pavarur*. Seksioni i çështjeve kryesore të auditimit është i detyrueshëm vetëm për entitetet e listuara.

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për aksionarët e shoqërisë tregtare ABC [ose një adresë tjetër e duhur]

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare¹⁹

Opinionin

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare ABC (shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) pozicionin financiar të shoqërisë me datën 31 Dhjetor 20X1, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

[Çështjet Kryesore të Auditimit²⁰

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje, ne nuk japim një opinion të veçantë.

[Përshkrimi për çdo çështje kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.]]

Informacione të tjera [ose një titull tjetër i përshtatshëm, si për shembull “Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to”]

¹⁹ Nëntitulli “Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare” nuk është i nevojshëm të vendoset kur raporti nuk përmban një nëntitull të dytë të emërtuar “Raport mbi Kërkesat e Tjera Ligjore dhe Rregullatore”.

²⁰ Seksioni për çështjet kryesore të auditimit kërkohet vetëm për entitetet e listuara.

Drejtimi²¹ është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë [informacionin që jepet në raportin X²², por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesit mbi këto pasqyra.]

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se janë me anomali materiale. Nëse, bazuar në punën e kryer, ne arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare²³

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar)²⁴ – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar)– shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Raport mbi Kërkesa të tjera Ligjore dhe Rregullatore

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

[Ortaku i angazhimit për auditimin përgjegjës për raportin e audituesit të pavarur është [emri]²⁵

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e audituesit]

[Data]

21 Ose terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor të juridiksionit përkatës.

22 Për të identifikuar informacionet e tjera mund të përdoret një përshkrim më specifik, si për shembull, “Raporti i drejtimit dhe deklarata e presidentit/kryetarit”.

23 Në të gjitha këto raporte audituesi ilustruese, termat drejtimi dhe personat e ngarkuar me qeverisjen mund të zëvendësohen me një term tjetër që është i përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor që zbatohet në një juridiksion të caktuar.

24 SNA 700 (i rishikuar), *Formimi i një opinionin dhe raportimi mbi pasqyrat financiare*

25 Emri i ortakut/partnerit të angazhimit përfshihet në raportin e audituesit për auditimet e paketave të plota të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme të entiteteve të listuara, përveç rasteve, në rrethana të rralla, kur dhënia e këtyre informacioneve parashikohet të shkaktojë kërcënime të mëdha personale (shiko SNA 700 (i rishikuar), paragrafi 46).

Ilustrimi 2 – Një raport i audituesit për një entitet të listuar që përmban një opinion të pamodifikuar, kur audituesi ka siguruar një pjesë të informacioneve të tjera para datës së raportit të audituesit, nuk ka identifikuar një anomali materiale në informacionet e tjera dhe parashikon të sigurojë pjesën tjetër të informacioneve të tjera pas datës së raportit të audituesit.

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti të listuar i cili përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi nuk është auditim i një grupi (d.m.th. nuk zbatohet SNA 600).
- Pasqyrat financiare janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se duhet të jepet një opinion i pamodifikuar (d.m.th. “i pastër”).
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato që janë në fuqi në juridiksionin përkatës (vendin përkatës).
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë, sipas SNA 570 (i rishikuar).
- Çështjet kryesore të auditimit janë komunikuar në pajtim me SNA 701.
- Audituesi i ka siguruar një pjesë të informacioneve të tjera përpara datës së raportit të audituesit, nuk ka identifikuar një anomali materiale në informacionet e tjera dhe parashikon të sigurojë pjesën tjetër të informacioneve të tjera pas datës së raportit të audituesit.
- Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Përveç auditimit të pasqyrave financiare, audituesi ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat kërkohen sipas legjislacionit lokal (të vendit përkatës).

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për aksionarët e shoqërisë tregtare ABC [ose një adresë tjetër e duhur]

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare²⁶

Opinionin

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare ABC (shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) pozicionin financiar të shoqërisë me datën 31 Dhjetor 20X1, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje, ne nuk japim opinion të veçantë.

[Përshkrimi për çdo çështje kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.]

Informacione të tjera [ose një titull tjetër i përshtatshëm, si për shembull “Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to”]

²⁶ Nëntitulli “Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare” nuk është i nevojshëm të vendoset, kur raporti nuk përmban një nëntitull të dytë të emërtuar “Raport mbi Kërkesat e Tjera Ligjore dhe Rregullatore”.

Drejtimi²⁷ është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë raportin X²⁸, (por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesit mbi këto pasqyra), të cilin ne e siguroam para datës së raportit të audituesit dhe raportin Y, i cili mendohet të na vihet në dispozicion pas kësaj date.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuara më lart, dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se janë me anomali materiale.

Nëse, bazuar në punën që kemi kryer mbi informacionet e tjera që kemi siguruar para datës së këtij raporti të audituesit, ne arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar për këto informacione.

[Pasi të lexojmë raportin Y, nëse arrijmë në përfundimin se në këtë raport ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me personat e ngarkuar me qeverisjen [përshkruhen veprimet që janë të zbatueshme në juridiksionin përkatës]]²⁹.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare³⁰

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar)– shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Raport mbi Kërkesa të tjera Ligjore dhe Rregullatore

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

27 Ose terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor të juridiksionit përkatës.

28 Për të identifikuar informacionet e tjera mund të përdoret një përshkrim më specifik, si për shembull, “Raporti i drejtimit dhe deklarata e presidentit/kryetarit”.

29 Mund të jete e dobishme të përfshihen paragrafë shtesë kur audituesi ka identifikuar një anomali materiale të pakorrigjuar për informacionet e tjera të siguruar pas datës së raportit të audituesit dhe ka një detyrim ligjor që si reagim të ndërmarrë një veprim të veçantë.

30 Ose terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor të juridiksionit përkatës.

PËRGJEGJËSITË E AUDITUESIT NË LIDHJE ME INFORMACIONET E TJERA

[Ortaku i angazhimit për auditimin përgjegjës për raportin e audituesit të pavarur është [emri]³¹

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e audituesit]

[Data]

31 Emri i ortakut/partnerit të angazhimit përfshihet në raportin e audituesit për auditimet e paketave të plota të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme të entiteteve të listuara, përveç rasteve, në rrethana të rralla, kur dhënia e këtyre informacioneve parashikohet të shkaktojë kërcënime të mëdha personale (shiko SNA 700 (i rishikuar), paragrafi 46).

Ilustrimi 3 – Një raport i audituesit për një entitet të pa listuar që përmban një opinion të pamodifikuar, kur audituesi ka siguruar një pjesë të informacioneve të tjera para datës së raportit të audituesit, nuk ka identifikuar një anomali materiale në informacionet e tjera dhe parashikon të sigurojë pjesën tjetër të informacioneve të tjera pas datës së raportit të audituesit.

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti të pa listuar i cili përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi nuk është auditim i një grupi (d.m.th. nuk zbatohet SNA 600).
- Pasqyrat financiare janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se duhet të jepet një opinion i pamodifikuar (d.m.th. “i pastër”).
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato që janë në fuqi në juridiksionin përkatës (vendin përkatës).
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhe dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë, sipas SNA 570 (i rishikuar).
- Audituesi nuk kërkohet, dhe ai nuk ka vendosur të komunikojë Çështjet kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.
- Audituesi i ka siguruar një pjesë të informacioneve të tjera përpara datës së raportit të audituesit, nuk ka identifikuar një anomali materiale në informacionet e tjera dhe parashikon të sigurojë pjesën tjetër të informacioneve të tjera pas datës së raportit të audituesit.
- Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Audituesi nuk ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat kërkohen sipas legjislacionit lokal (të vendit përkatës).

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për aksionarët e shoqërisë tregtare ABC [ose një adresë tjetër e duhur]

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare ABC (shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) pozicionin financiar të shoqërisë me datën 31 Dhjetor 20X1, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera [ose një titull tjetër i përshtatshëm, si për shembull “Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to”]

Drejtimi³² është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera të siguruar në datën e këtij raporti të audituesit përfshijnë [informacionet që jepen në raportin X³³, por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesit mbi këto pasqyra].

Opinionit ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

³² Ose terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrin ligjor të juridiksionit përkatës.

³³ Për të identifikuar informacionet e tjera mund të përdoret një përshkrim më specifik, si për shembull, “Raporti i drejtimit dhe deklarata e presidentit/kryetarit”.

Nëse, bazuar në punën që kemi kryer mbi informacionet e tjera të siguruara para datës së këtij raporti të audituesit, ne arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar për këto informacione.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare³⁴

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar)– shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Raport mbi Kërkesa të tjera Ligjore dhe Rregullatore

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e audituesit]

[Data]

34 Ose terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor të juridiksionit përkatës.

Ilustrimi 4 – Një raport i audituesit për një entitet të listuar që përmban një opinion të pamodifikuar, kur audituesi nuk ka siguruar asnjë informacion tjetër para datës së raportit të audituesit, por parashikon që informacionet e tjera ti sigurojë pas datës së raportit të audituesit.

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti të listuar, i cili përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi nuk është auditim i një grupi (d.m.th. nuk zbatohet SNA 600).
- Pasqyrat financiare janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se duhet të jepet një opinion i pamodifikuar (d.m.th. “i pastër”).
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato që janë në fuqi në juridiksionin përkatës (vendin përkatës).
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë, sipas SNA 570 (i rishikuar).
- Çështjet kryesore të auditimit janë komunikuar në pajtim me SNA 701.
- Audituesi nuk ka siguruar asnjë informacion tjetër përpara datës së raportit të audituesit, por parashikon që informacionet e tjera t’i sigurojë pas datës së raportit të audituesit.
- Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Përveç auditimit të pasqyrave financiare, audituesi ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat kërkohen sipas legjislacionit lokal (të vendit përkatës).

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për aksionarët e shoqërisë tregtare ABC [ose një adresë tjetër e duhur]

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare³⁵

Opinionin

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare ABC (shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) pozicionin financiar të shoqërisë me datën 31 Dhjetor 20X1, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje, ne nuk japim opinion të veçantë.

[Përshkrimi për çdo çështje kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.]

Informacione të tjera [ose një titull tjetër i përshtatshëm, si për shembull “Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to”]

³⁵ Nëntitulli “Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare” nuk është i nevojshëm të vendoset, kur raporti nuk përmban një nëntitull të dytë të emërtuar “Raport mbi Kërkesat e Tjera Ligjore dhe Rregullatore”.

Drejtimi³⁶ është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë [informacionet që jepen në raportin X³⁷, por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesit mbi këto pasqyra]. Raporti X parashikohet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuara më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

[Pasi të lexojmë raportin X, nëse arrijmë në përfundimin se në këtë raport ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me personat e ngarkuar me qeverisjen [përshkruhen veprimet që janë të zbatueshme në juridiksionin përkatës]]³⁸.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare³⁹

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar)– shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Raport mbi Kërkesa të tjera Ligjore dhe Rregullatore

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

[Ortaku i angazhimit për auditimin përgjegjës për raportin e audituesit të pavarur është [emri]

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e audituesit]

[Data]

36 Ose terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor të juridiksionit përkatës.

37 Për të identifikuar informacionet e tjera mund të përdoret një përshkrim më specifik, si për shembull, “Raporti i drejtimit dhe deklaratat e presidentit/kryetarit”.

38 Ky paragraf shtese mund të jetë i dobishëm kur audituesi ka identifikuar një anomali materiale të pakorrigjuar për informacionet e tjera të siguruar pas datës së raportit të audituesit dhe ka një detyrim ligjor që si reagim të ndërmarrë një veprim të veçantë.

39 Ose terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor të juridiksionit përkatës.

Ilustrimi 5 – Një raport i audituesit për një entitet të listuar ose të pa listuar, që përmban një opinion të pamodifikuar, kur audituesi ka siguruar të gjitha informacionet e tjera para datës së raportit të audituesit dhe ka arritur në përfundimin se në informacionet e tjera ka një anomali materiale.

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti të listuar ose të pa listuar, i cili përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi nuk është auditim i një grupi (d.m.th. nuk zbatohet SNA 600).
- Pasqyrat financiare janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se duhet të jepet një opinion i pamodifikuar (d.m.th. “i pastër”).
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato që janë në fuqi në juridiksionin përkatës (vendin përkatës).
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë, sipas SNA 570 (i rishikuar).
- Çështjet kryesore të auditimit janë komunikuar në pajtim me SNA 701.
- Audituesi i ka siguruar të gjitha informacionet e tjera përpara datës së raportit të audituesit dhe ka arritur në përfundimin se në informacionet e tjera ka një anomali materiale.
- Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.
- Audituesi nuk ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat kërkohen sipas legjisllacionit ose rregullave.

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për aksionarët e shoqërisë tregtare ABC [ose një adresë tjetër e duhur]

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare ABC (shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose *japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për*) pozicionin financiar të shoqërisë me datën 31 Dhjetor 20X1, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera [ose një titull tjetër i përshtatshëm, si për shembull “Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to”]

Drejtimi⁴⁰ është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë [informacionet që jepen ne raportin X⁴¹, por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesit mbi këto pasqyra].

Opinionit ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuar më lart, kur ato të na vihen ne dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo

40 Ose terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor të juridiksionit përkatës.

41 Për të identifikuar informacionet e tjera mund të përdoret një përshkrim më specifik, si për shembull, “Raporti i drejtimit dhe deklarata e presidentit/kryetarit”.

me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Nëse, bazuar në punën që kemi kryer, arrijmë në përfundimin se në informacionet e tjera ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Siç përshkruhet më poshtë, ne kemi arritur në përfundimin se ka një anomali materiale në informacionet e tjera. *[Përshkrimi i anomalisë materiale në informacionet e tjera].*

[Çështjet Kryesore të Auditimit ⁴²

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje, ne nuk japim opinion të veçantë.

[Përshkrimi për çdo çështje kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.]

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare ⁴³

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar)– shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Raport mbi Kërkesa të tjera Ligjore dhe Rregullatore

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

[Ortaku i angazhimit për auditimin përgjegjës për raportin e audituesit të pavarur është emri]⁴⁴

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e audituesit]

[Data]

⁴² Seksioni për çështjet kryesore të auditimit kërkohet vetëm për entitetet e listuara.

⁴³ Ose terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor të juridiksionit përkatës.

⁴⁴ Emri i ortakut/partnerit të angazhimit përfshihet në raportin e audituesit për auditimet e paketave të plota të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme të entiteteve të listuara, përveç rasteve, në rrethana të rralla, kur dhënia e këtyre informacioneve parashikohet të shkaktojë kërcënime të mëdha personale (shiko SNA 700 (i rishikuar), paragrafi 46).

Ilustrimi 6 – Një raport i audituesit për një entitet të listuar ose jo, që përmban një opinion me rezervë, kur audituesi ka siguruar të gjitha informacionet e tjera para datës së raportit të audituesit dhe ka një kufizim në objekt në lidhje me një element material në pasqyrat financiare të konsoliduara, i cili ndikon edhe në informacionet e tjera.

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të konsoliduara të një entiteti të listuar ose të pa listuar, i cili përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi është auditim i një grupi (d.m.th. zbatohet SNA 600).
- Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Audituesi nuk ka qenë në gjendje të sigurojë evidencën e nevojshme të auditimit në lidhje me investimin në një pjesëmarrje të huaj. Efektet e mundshme të pamundësisë për të siguruar evidencën e nevojshme të auditimit, gjykohet se janë materiale por jo të përhapura në pasqyrat financiare të konsoliduara (d.m.th. duhet të jepet një opinion i modifikuar).
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato që janë në fuqi në juridiksionin përkatës (vendin përkatës).
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë, sipas SNA 570 (i rishikuar).
- Çështjet kryesore të auditimit janë komunikuar në pajtim me SNA 701.
- Audituesi i ka siguruar të gjitha informacionet e tjera përpara datës së raportit të audituesit dhe çështja që çon në opinionin me rezervë mbi pasqyrat financiare të konsoliduara, ndikon edhe në informacionet e tjera.
- Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare të konsoliduara ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara.
- Audituesi nuk ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat kërkohen sipas legjislacionit ose rregullave.

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për aksionarët e shoqërisë tregtare ABC [ose një adresë tjetër e duhur]

Opinionit me reserve

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë tregtare ABC dhe filialeve të saj (Grupi), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse të konsoliduara, pasqyrën e ndryshimeve në kapital të konsoliduar dhe pasqyrën e flukseve të parasë të konsoliduar për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të mundshme të çështjes së përshkruar në seksionin e *Bazës për Opinionin me Rezervë* të raportit tone, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose *japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për*) pozicionin financiar të Grupit me datën 31 Dhjetor 20X1, dhe performancën financiare të konsoliduar e flukset e parasë të konsoliduara për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin me reserve

Investimi i Grupit në shoqërinë tregtare XYZ, një pjesëmarrje e huaj e blerë gjatë vitit dhe e njohur me metodën e kapitalit, është paraqitur me shumën xxx në pasqyrën financiare të konsoliduar të pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1 dhe pjesa e shoqërisë ABC në të ardhurat neto të XYZ në shumën xxx është përfshirë në të ardhurat e shoqërisë ABC për vitin që mbyllet me këtë datë. Ne nuk ishim në gjendje të siguronim evidencën e nevojshme të auditimit për vlerën kontabël të investimit të shoqërisë ABC në pjesëmarrjen XYZ me datën 31 Dhjetor 20X1 dhe pjesën e ABC në të ardhurat neto të XYZ për vitin, për shkak se ne na u refuzua aksesit në informacionet financiare, kontakti me drejtuesit dhe audituesit e XYZ. Për pasojë ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse ishte i nevojshëm të bëhej ndonjë korigjim në këto shuma.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara*. Ne jemi të pavarur nga Grupi në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

Informacione të tjera [ose një titull tjetër i përshtatshëm, si për shembull “Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to”]

Drejtimi⁴⁵ është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë [informacionet që jepen në raportin X⁴⁶, por nuk përfshijnë pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportin tonë të audituesit mbi këto pasqyra].

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Nëse, bazuar në punën që kemi kryer, arrijmë në përfundimin se në informacionet e tjera ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Siç përshkruhet në seksionin e *Bazës për Opinionin me rezervë*, ne nuk ishim në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për vlerën kontabël të investimit të ABC në XYZ me datën 31 Dhjetor 20X1 dhe pjesën e ABC në të ardhurat neto të XYZ për vitin. Për pasojë ne nuk ishim në gjendje të arrinim në përfundimin nëse ka ose jo anomali materiale në informacionet e tjera në lidhje me këtë çështje.

[Çështjet Kryesore të Auditimit ⁴⁷

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje, ne nuk japim opinion të veçantë. Përveç çështjes së përshkruar në seksionin e *Bazës për Opinionin me rezervë*, ne kemi përcaktuar si çështje kryesore të auditimit, çështjet që përshkruhen me poshtë, të cilat do të komunikohen në raport.

[Përshkrimi për çdo çështje kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.]

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare⁴⁸

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 2 në SNA 700 (i rishikuar).]

45 Ose terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor të juridiksionit përkatës.

46 Për të identifikuar informacionet e tjera mund të përdoret një përshkrim më specifik, si për shembull, “Raporti i drejtimit dhe deklarata e presidentit/kryetarit”.

⁴⁷ Seksioni për çështjet kryesore të auditimit kërket vetëm për entitetet e listuara.

48 Ose terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor të juridiksionit përkatës.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar)– shiko Ilustrimin 2 në SNA 700 (i rishikuar).]

Raport mbi Kërkesa të tjera Ligjore dhe Rregullatore

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 2 në SNA 700 (i rishikuar).]

[Ortaku i angazhimit për auditimin përgjegjës për raportin e audituesit të pavarur është [emri]⁴⁹

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e audituesit]

[Data]

⁴⁹ Emri i ortakut/partnerit të angazhimit përfshihet në raportin e audituesit për auditimet e paketave të plota të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme të entiteteve të listuara, përveç rasteve, në rrethana të rralla, kur dhënia e këtyre informacioneve parashikohet të shkaktojë kërcënime të mëdha personale (shiko SNA 700 (i rishikuar), paragrafi 46).

Ilustrimi 7 – Një raport i audituesit për një entitet të listuar ose të pa listuar, që përmban një opinion kundër, kur audituesi ka siguruar të gjitha informacionet e tjera para datës së raportit të audituesit dhe opinionin kundër mbi pasqyrat financiare të konsoliduara ndikon edhe në informacionet e tjera.

Për qëllime të këtij raporti ilustrues të audituesit, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të konsoliduara të një entiteti të listuar ose jo, i cili përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi është auditim i një grupi (d.m.th. zbatohet SNA 600).
- Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Pasqyrat financiare të konsoliduara kane anomali materiale për shkak të mos konsolidimit të një filiali. Duket se anomalia në pasqyrat financiare të konsoliduara është e përhapur. Efektet e anomalisë në pasqyrat financiare të konsoliduara nuk janë përcaktuar, pasi nuk ishte e mundur të bëhej (d.m.th. duhet të jepet një opinion kundër).
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato që janë në fuqi në juridiksionin përkatës (vendin përkatës).
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë, sipas SNA 570 (i rishikuar).
- Çështjet kryesore të auditimit janë komunikuar në pajtim me SNA 701.
- Audituesi i ka siguruar të gjitha informacionet e tjera përpara datës së raportit të audituesit dhe çështja që çon në opinionin kundër mbi pasqyrat financiare të konsoliduara, ndikon edhe në informacionet e tjera.
- Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare të konsoliduara ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara.
- Audituesi nuk ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat kërkohen sipas legjisllacionit ose rregullave.

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për aksionarët e shoqërisë tregtare ABC [ose një adresë tjetër e duhur]

Opinionin kundër

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë tregtare ABC dhe të filialeve të saj (Grupi), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse të konsoliduara, pasqyrën e ndryshimeve në kapital të konsoliduar dhe pasqyrën e flukseve të parasë të konsoliduar për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, për shkak të rëndësisë së çështjes të përshkruar në seksionin e *Bazës për Opinionin Kundër* të raportit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur nuk paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose nuk *japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për*) pozicionin financiar të Grupit me datën 31 Dhjetor 20X1, dhe performancën financiare të konsoliduar, dhe flukset e parasë të konsoliduara për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin Kundër

Sikurse shpjegohet në shënimin X, Grupi nuk ka konsoliduar filialin e tij shoqërinë XYZ, një shoqëri që Grupi e ka blerë gjatë 20X1, për shkak se nuk ka qenë në gjendje të përcaktojë vlerat e drejta të disa aktiveve dhe detyrimeve materiale në datën e blerjes. Për këtë arsye, investimi është njohur mbi bazën e kostos. Sipas SNRF-ve Grupi duhet ta kishte konsoliduar këtë filial dhe ta kishte njohur për blerjen, bazuar në shumat provizore. Nëse shoqëria XYZ do të kishte qenë konsoliduar, shumë elemente në pasqyrat financiare të konsoliduara do të ndikoheshin materialisht. Efektet në pasqyrat financiare të konsoliduara të mos-konsolidimit nuk janë përcaktuar.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara*. Ne jemi të pavarur nga Grupi në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara (të zbatueshme në juridiksionin përkatës dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë kundër.

Informacione të tjera [ose një titull tjetër i përshtatshëm, si për shembull “Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to”]

Drejtimi⁵⁰ është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë [informacionet që jepen në raportin X⁵¹, por nuk përfshijnë pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportin tonë të audituesit mbi këto pasqyra].

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se janë me anomali materiale. Nëse, bazuar në punën që kemi kryer, ne arrijmë në përfundimin se në informacionet e tjera ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Siç përshkruhet në seksionin e *Bazës për Opinionin kundër*, Grupi duhet të kishte konsoliduar shoqërinë XYZ dhe njohur blerjen bazuar në shumat provizore. Ne kemi arritur në përfundimin se për të njëjtat arsye edhe informacionet e tjera kanë anomali materiale në lidhje me shumat ose elementet e tjera në raportin X, të ndikuara nga mos konsolidimi i shoqërisë XYZ për vitin.

[Çështjet Kryesore të Auditimit⁵²

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje, ne nuk japim opinion të veçantë. Përveç çështjes së përshkruar në seksionin e *Bazës për Opinionin kundër*, ne kemi përcaktuar si çështje kryesore të auditimit, çështjet që përshkruhen më poshtë, të cilat komunikohen në raportin tone.

[Përshkrimi për çdo çështje kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.]

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare⁵³

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 2 në SNA 700 (i rishikuar).]

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

50 Ose terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor të juridiksionit përkatës.

51 Për të identifikuar informacionet e tjera mund të përdoret një përshkrim më specifik, si për shembull, “Raporti i drejtimit dhe deklarata e presidentit/kryetarit”.

⁵² Seksioni për çështjet kryesore të auditimit kërket vetëm për entitetet e listuara.

53 Ose terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor të juridiksionit përkatës.

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar)– shiko Ilustrimin 2 në SNA 700 (i rishikuar).]

Raport mbi Kërkesa të tjera Ligjore dhe Rregullatore

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 2 në SNA 700 (i rishikuar).]

[Ortaku i angazhimit për auditimin përgjegjës për raportin e audituesit të pavarur është [emri]⁵⁴

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e audituesit]

[Data]

⁵⁴ Emri i ortakut/partnerit të angazhimit përfshihet në raportin e audituesit për auditimet e paketave të plota të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme të entiteteve të listuara, përveç rasteve, në rrethana të rralla, kur dhënia e këtyre informacioneve parashikohet të shkaktojë kërcënime të mëdha personale (shiko SNA 700 (i rishikuar), paragrafi 46).